

që ndritshin borën e bardhë. Prej larg dukeshin si rreze qiellore. Ndërsa udhtarët, pelegrinët çobanë e mbretën të maleve drejtoheshin kah drita e asaj komete toksore. Kje me të vërtetë një natë e mrekullueshme. Drita asht ma e fortë se sytë dhe depërton drejt e në mendje e zemra të njerëzve. (Vetëm qorrat qorra mbeten gjithmonë qorra). U ngazllje i gjithë populli e me të edhe un. Ajo kje e pra natë që kishem rreth vedit të mbledhun përfaqësuesët nga të gjitha lagjet e Shoshit. Para se me fillue ceremonitë fetare të natës, fëmijët e mësue prej meje filluen programin festiv. Kënduen disa kangë e sidomos recituen aq bukur vjershat e pregatituna për atë natë, sa populli, i kënaqun prej fëmijëve të vet, më dhanë lavdet mue se kishen pasë aq kujdes me i mësue ashtu. E vetmja gja që u prishej ishte mendimi i largimit tem, porsa të shkrihej bora e të dalin prandvera”

(Teksti vjen nga faqja e internet Radio Vatikani shqip)

Papa: misteri i takimit tonë me Zotin kuptohet në heshtje, larg publicitetit



Vetëm heshtja e ruan misterin e udhës, që bën njeriu me Zotin. E pohoi Papa Françesku në homelinë e Meshës, kryesuar sot paradite në Shtëpinë e Shën Martës. Zoti, shtoi Papa, na jep hirin ta duam heshtjen. E heshtja duhet ruajtur, larg çdo publiciteti. Në historinë e shëlbimit, nuk janë zhurma, as dalja sheshit, por hija e heshtja “vendet” që zgjodhi Zoti, për t’iu dëftuar njeriut. Kufij të vagëlluar, ku misteri i

tij mori herë pas here formë të dukshme, mori mish e gjak. U frymëzua nga fragmenti i sotëm ungjillor i Lajmërimit të Zojës, Papa. Posaçërisht nga çasti, kur Engjëlli i kumton Marisë se fuqia e të Tejetlartit ‘do ta mbulonte me hijen e vet’. Gati-gati, kujtoi Papa, e njëgjëjtë, si hija, ishte edhe reja, me të cilën Zoti i mbrojti hebrenjtë në shkretëtirë: “Zoti ka pasur gjithmonë

kujdes për misterin, e ka mbuluar gjithnjë. Nuk ka bërë publicitet për misterin. Misteri, që bën publicitet për vete, nuk është i krishterë, nuk është mister i Hyjit: është mister i rremë! E kjo i ndodhi Zojës së Bekuar në çastin e lajmërimit, kur mori të Birin: misteri i amësisë së Saj virgjërore është i mbuluar. E mbuluar, gjithë jeta e Saj. E Ajo e dinte. Kjo hije e Zotit, në jetën tonë, na ndihmon të zbulojmë misterin; misterin e takimit me Zotin, misterin e ecjes sonë në udhët e jetës, me Zotin”. Secili nga ne, pohoi Papa, e di sa misteriozisht vepron Zoti në zemrën tonë, në shpirtin tonë. E cila është, shtoi Ati i Shenjtë, reja, pushteti, stili, me të cilin e mbulon Shpirti Shenjt misterin tonë? “Kjo re në ne, në jetën tonë, quhet heshtje: heshtja është pikërisht reja, që mbulon misterin e marrëdhënies sonë me Zotin, e shenjtërisë sonë, e mëkateve tona. E këtë mister nuk mund ta shpjegojmë. Por kur në jetën tonë thyhet heshtja, misteri humbet, zhduket. Misteri duhet ruajtur me heshtje. Kjo është reja, është pushteti i Zotit për ne, kjo është forca e Shpirtit Shenjt”. Nëna e Krishtit ishte ikona e përkryer e heshtjes. Nga kumti i amësisë së Saj e deri në Kalvar. Mendoj, vërejtj Papa Françesku, sa herë iu desh të heshtë, e sa herë nuk e tha atë, që ndjente, për të ruajtur misterin e lidhjes së Saj me të Birin. Deri në heshtjen më zemërcjerrëse, tek këmbët e Kryqit: “Ungjilli nuk na thotë asgjë për këtë: nuk na tregon tha a nuk tha ndonjë fjalë ... Heshti, po brenda zemrës së Saj sa fjalë u thanë! Sa gjatë foli me Zotin! ‘Ti, atë ditë, më pate premtuar se do të ishte i madh; më pate thënë se do t’i jepshe fronin e Davidit, atit të tij, se do të mbretëronte përgjithmonë. E tani, e shikoj atje!’. Zoja ishte njerëzore! E ndoshta-ndoshta kishte dëshirë të thoshte edhe: ‘Gënjeshtra! U mashtrova!’”. Gjon Pali II e ka pohuar këtë, duke folur për ndjesitë e Zojës në këtë çast tragjik. Po ajo diti ta mbulojë misterin, që nuk e kuptonte, me heshtje, e me këtë heshtje e la këtë mister të rritej, të gjethonte e të çelte lule shprese”. Heshtja e ruan misterin, prandaj misteri i lidhjes sonë me Zotin, i udhës sonë, i shëlbimit tonë, përsëriti Papa Françesku, nuk mund të nxirret në vitrinë, nuk mund të bëhet plaçkë publiciteti. Zoti na dhëntë hirin të duam në heshtje, ta ruajmë zemrën tonë të mbështjellë me renë e heshtjes.

twitter



Pope Francis @Pontifex

This Christmas may we be consistent in living the Gospel, welcoming Jesus into the centre of our lives.

Ylli BEQIRI CPA.CGA

BEQIRI
PROFESSIONAL CORPORATION

Tel: 416-854-9156
Fax: 1-888-838-7736
974 The Queensway,
Toronto ON M8Z 1P6
ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Qera Shtëpi, Condo A Po Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethinat)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience Special Rates Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.

*** Call for Details**

Rates Subject To Change Without Notice and OAC

Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage*
2150 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

Misioni Shqiptar

'E Lumja Nënë Tereza'

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

EMANUEL, Zoti me ne!


22 DHJETOR 2013



Indja e Jezu Krishtit ndodhi kështu: Maria, nëna e tij, pasi u fejua me Jozefin, para se të banonin së bashku, u gjet shtatzënë për virtyt të Shpirtit Shenjt. Tashti Jozefi, i fejuari i saj, pasi ishte njeri i drejtë e nuk donte ta publikonte çështjen, mendoi ta lëshojë fshehtazi. Posa në mendje të vet vendosi të bëjë kështu, ja se, iu duk në ëndërr engjëlli i Zotit dhe i tha: “Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh Marinë, të fejuarën tënde, sepse foshnja që është zënë në të, u zu për virtyt të Shpirtit Shenjt. Ajo do të lindë djalë e ti ngjitja emrin Jezus, sepse Ai do ta shëlbtojë popullin e vet prej mëkateve të tija.” E gjithë kjo ngjau që të shkonte në vend fjala e Zotit e thënë nëpër profetin: “Qe, Virgjëra do të mbesë shtatzënë e do të lindë një djalë, të cilit do t’ia ngjesin emrin Emanuel – që do të thotë: Hyji me ne!” Jozefi, si u zgjua nga gjumi, bëri sikurse i urdhëroi engjëlli i Zotit: e mori në shtëpi të fejuarën e vet. *Mt 1,18-24*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN’S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown’s Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com** ose kunsulto harten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

23	Dhjetor	Shen Gjoni nga Kety
25	Dhjetor	Krishtlindja
26	Dhjetor	Shen Shtjefni
27	Dhjetor	Shen Gjoni apostull
28	Dhjetor	Femijet e pafajshem
29	Dhjetor	Familja Shenjte

Nata e Krishtlindjes 24 dhjetor...

Mesha kremtohet ne darke ne oren 11:30



Krishtlindje 25 dhjetor...

Mesha ditën e Krishtlindjes kremtohet ne oren 12:30

Bekimet e shtepiave...

Kush deshiron ti bekohet shtepia te lajmeroje Meshtarin ne numrat 416-503-4509 ose 647-558-9382. Bekimet jane çdo jave nga e hena deri te shtunen.

Femijet per Kungim te Pare dhe Krezmim...

Femijet qe rregjistrohen per Kungim te Pare (First

Communion) dhe Krezmim (Confirmation) duhet te sjellin kopie te Çertifikates se Pagezimit.

Hakun e Kishes per vitin 2013

kane dhene Gjovalin Luli, Ilir Gjokaj, Luigj Lallinaj, Arben Pepa, David Shtjefhilaj.	
Don Gjovani K.	Kokona
Agron	Vata
Aleks	Coku
Aleks	Stolaj
Aleksander&Adrian	Cukaj
Alfons	Tarazhi
Alfred	Shllaku
Altin	Miri
Anton	Brunga
Anton	Vulevic (Vulaj
Anton	Malaj
Anton & Violeta	Selmanaj
Arben	Toma
Arben	Marku
Arben	Pepa
Astrit & Ermira	Simeqi
Beniamin	Hasko
Edi	Linadi
Edmond	Kacorri
Enton	Nesha
Erion	Tase
Fabian	Pllumaj
Florenc	Duro
Fred	Kalaj
Gac	Gjoka
Gazmend	Gjidoda
Gjek & Lec	Gashaj
Gjergj	Gjinaj
Gjergj & Barbara	Nikolla
Gjovalin	Luli
Gjovalin	Melaj
Gjovalin & Sandra	Selmani
Ilir	Shyti
Ilir	Daka
Ilir	Gjokaj
Jetnor	Smakaj
Kreshnik	Malaj
Lek	Selmani
Leke	Kapllaj
Linda	Kalavaci
Ljuc	Juncaj
Luigj	Groshi
Luigj	Lallinaj
Luk	Gjolaj
Malot	Hasaj
Marin	Muzhani
Mario	Martini
Mark	Ndoci
Mark	Shkreli
Martin	Vuktilaj
Martin	Pjetri
Ndok	Macaj
Nikolin	Vukelaj
Nua	Selmani
Nue	Nikci
Nush	Kacaj
Pal	Rransburgaj
Paulin	Marku
Paulin	Lukani
Petrit (Pero)	Ujka
Pjerin	Kalaj
Pjeter	Tunaj
Pjeter & Bep	Dreshaj
Prek	Kacaj
Prek	Gjonaj
Prek	Spaqi
Prel	Pepushaj
Rozina	Kalaj
Rrok	Gjoni

Shtjefen	Gjuravçaj
Silvan	Nerhati
Sokol	Ujka
Sokol	Gashaj
Taulant	Dedja
Tom	Merditaj
Tome	Ivanaj
Tony	Isufaj
Valete (Vladimir)	Gjokaj
Vasel	Dreshaj
Viktor	Dokaj
Viktor	Pleti
Vitor	Mernacaj
Vladimir	Doda
Zef	Lulaj
Zef	Deklaj
Zef	Skrela (Shkreli)
Zef	Prela

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Klshes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollarë dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Krishtlindja, në kryevepra proze: P. Zef Pllumi OFM “Nata e Krishtlindjes në malësi” (Emisioni XI)



Sot, në rubrikën **“Krishtlindja, në kryevepra proze”** (Emisioni XII), zgjodhëm një fragment nga epopeja e mirënjohur e atë Zef Pllumit “Rrno vetëm për me tregue”. I shkëputur nga vëllimi II i librit, titullohet “Nata e Këshndellave në malësi”. Por para se të nisim leximin, po përpiqemi ta përmbledhim me dy rreshta, një jetë, që tregohet në një mori vëllimesh, tashmë të botuara. Atë Zef Pllumi(28 gusht 1924, Mali i Rrencit–26 shtator 2007, Romë), frat françeskan, publicist e shkrimtar, pas 26 vjet burgimi, botoi, ndërmjet tjerash, tre vëllime me titullin: “Rrno vetëm për me tregue”, që lexuesit e vlerësuan si “Arkipelagu Gulag” shqiptar. Aktakuzë e rëndë kundër regjimit që shkoi, e edhe kundër atij, që e pasoi, libri klasifikohet me vështirësi ndërmjet llojeve e zhanreve që njeh letërsia. Është i gjinisë epike, pa dyshim. I llojit të prozës dokumentare. Por në të gjen faqe, që të kujtojnë romanin, gjen pjesë që i takojnë historisë së Kishës, çaste fetare meditative, fragmente të holla lirike e, sidomos, një venë të mprehtë satirike, që të kujton se autori e njihte mirë çerdhen e “Anzave të Parnasit”. Këto elemente ndjehen fort edhe në fragmentin e zgjedhur për lexim në rubrikën“Krishtlindja, në kryevepra proze”, në



Remember, O most gracious Virgin Mary, that never was it known that anyone who fled to your protection, implored your help, or sought your intercession, was left unaided. Inspired with this confidence, I fly to you, O Virgin of virgins, my Mother. To you I come, before you I stand, sinful and sorrowful. O Mother of the Word Incarnate, despise not my petitions, but in your mercy, hear and answer me. Amen.

të cilin autor kujton kremtimin e Lindjes së Krishtit, kur ishte famullitar në Dukagjin: “Mora vesht se qysh me hymjen në fuqi të Statutit të Kishës organet e pushtetit kishin lejue edhe festimin e Natës së Këshndellave, sikurse lutej dikur.Fillova pregatitjet: sajova nja dy–tri vjersha Këshndellash, simbas mendësisë të maleve. Zoti më faltë, por e paraqitshem sikur Krishti të kishte le ndër këto male tona e jo në Betlehem. Po gjithashtu pikturova nja dy tre engjuj; nuk ishem piktor profesionist, megjithkëta paesazhet e dekoracionin i kam ushtruar që në fëmijni. Në një kand të Kishës pregatita Shpellën e Betlehemit me gjethe, lule, bar e shkambij. Dërgova në Shkodër Vatën, djalin e ri, me një adresë në dorë, për me ble 10 litër benzinë dhe dy petromaksa. Njanin e vuna në punë menjherë e, kur e ndeza, dola me të në dorë aty jashtë. Shëndriti e gjithë Kodra e Kishës së Shën Qurkut. Njerëzit atë natë e kishin pa së largu prej katundeve tjera që shtriheshin ndër shpate e bria të maleve. Mandej hyna në kasollen time të mjerë. Ata dy fëmijë, Pepa e Mirashi, ishin tepër të gëzuar. N’e nesre ndër gjithë lagjet e Ndragjinaj, Gjoshaj e Pilotaj edhe Palaj u përhap fjala- si duket ma shumë prej atyne dy fëmijve –se frati i ri kishte ble dy elektrinë, një për vedi e tjetrin për lopën. Pa kaluar mirë 24 orë filluen me ardhë njerëz me më këshillue: “More zotni, lopët tona hanë edhe në terr, por a ke me u vu gja para!”. Të gjithëve ua lashë tehin mbarë. Vetëm kur mbërrini Nata e Këshndellave, porsa filluen me u dukë nga të gjitha anët e brijave e shpateve flakët e vravashkave të cilat drejtoheshin të gjitha për te Kisha, pregatita edhe petromaksin e dytë. Mbasi e ndeza dola jashtë. Bora e ngrime ndriste nën dritën e petromaksit. Nuk frynte erë. E vendosa atë dritë jashtë, deri që filluen me mbrijtë çetat e para të njerëzve; vetëm atëherë e shtina në Kishë, e cila shëndriti siçmos kurrë. Nga gjashtë dritaret e Kishës shpërthejshin rreze,